



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR

Nr. 64 Prot.

Gjirokastër, më 19.01.2023

Lënda: Hapet thirrja për pjesëmarrje në shkollën verore të Universitetit të Vjenës.

Universiteti i Vjenës organizon çdo vit një shkollë verore ndërkombëtare për studentë dhe akademikë nga e gjithë bota në Strobl, në liqenin Wolfgang. "Univie: shkolla verore për Studime Evropiane dhe Ndërkombëtare 2023" do të mbahet nga data 15 korrik deri më 12 gusht 2023.

Programi katërvjor ofron kurse cilësore të Austrian Arbitration Academy dhe kurse të gjuhës gjermane. Kurset e Studimeve Evropiane mbahen në gjuhën angleze dhe trajtojnë aspektet politike, ekonomike, ligjore, historike dhe kulturore të zhvillimit të Evropës dhe Bashkimit Evropian. Austrian Arbitration Academy merret me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërkombëtare përmes gjykatave të arbitrazhit.

Studentë nga e gjithë bota zgjedhin shkollën verore jo vetëm për shkak të reputacionit të saj të jashtëzakonshëm akademik dhe mundësive të shkëlqyera për të studiuar gjuhën gjermane, por edhe për shkak të vendndodhjes, direkt në brigjet e liqenit Wolfgang në Salzkammergut.

Jeta në kampus krijon një atmosferë në të cilën inkurajohet shkëmbimi ndërkulturor dhe social dhe nxitet mirëkuptimi i ndërsjellë brenda komunitetit ndërkombëtar të studentëve. Pjesëmarrësit kanë mundësinë të zgjerojnë horizontet e tyre, të takojnë kolegë nga fusha të tjera studimi, të krijojnë miqësi dhe lidhje për karrieren e tyre të ardhshme profesionale.

Informacione të mëtejshme gjenden në faqen e internetit në: <http://shs.univie.ac.at/summer-school/>

Prof. dr. Bektash Mema

REKTOR

